

Mjediset ligatinore më të rendësishme në vend

P.M “Lumi Buna - Velipojë” përfshin lumin Bunë dhe zonën bregdetare-ligatinore të Velipojës. Rrjedha e fortë e lumenjve Drin e Bunë ka krijuar një nga sistemet më të rëndësishme ligatinore në Shqipëri, duke siguruar një habitat të rëndësishëm për shumë lloje shtazore dhe bimore. Njëherazi shërben si rezervuar kompensues për zonën e përmytjes së Bunës, duke ruajtur ekuilibrin e ujit dhe zvogëlimin e përmytjeve. Sedimentet e mbartura nga Buna kanë një rol të rëndësishëm për morfologjinë e bregdetit dhe të vijës bregdetare, e cila është subjekt i erozionit bregdetar në zonën e Velipojës.

Në P.M “Lumi Buna - Velipojë” evidentohen 26 tipe habitatesh, sipas Listës së Habitatesh të NATURA 2000, prej të cilave 7 tipe habitatesh të listuara si prioritare, të cilat kërkojnë masa specifike për ruajtje e tyre.

Peizazhi i Mbrojtur Lumi Buna - Velipojë



Peizazhi i Mbrojtur Lumi Buna - Velipojë

AdZM Shkodër

Përbërja e mjedisit ligatinor:

Laguna e Vilunit
Këneta e Mërtemës
Këneta e Domit
Këneta e Velipojës
Liqeni i Shasit
Lumi Buna

Shpendët që hasim në park:

Karabullaku i vogël
Skifteri këmbëkuq
Turtulli
Kryekuqe e mjemë
Rosa e zezë krahbardhë
Kredharaku me veshë.

Specie të spikatura të florës:

Zambakët e ujit
Arra e ujit
Kallamishtet
Plepat
Shelgjet
Frashëri



Rezervati Natyror i Menaxhuar Kune – Vain – Tale – Patok – Fushëkuqe – Ishëm

AdZM Lezhë

R.N.M Kune-Vain-Tale-Patok-Fushëkuqe-Ishëm ndahet në 2 rajone.

Rajoni “Kune-Vain-Tale”, shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë, i vendosur në deltën e rrjedhës së poshtme të Drinit. Ekosistemi kompleks lagunor është një habitat i rëndësishëm për dimërimin e rosave dhe zonë riprodhimi për shumë lloje peshqish.

Rajoni “Patok-Fushëkuqe-Ishëm” ndodhet midis deltës së lumit Mat dhe Kepit të Rodonit. Larmia e llojeve të habitateve ujore dhe klima e përshtatshme subtropikale kanë favorizuar rritjen e një bimesie të zhvilluar submerse, pyjore, halofite dhe të dunave ranore.

Në RNM Kune-Vain-Tale janë evidentuar: 16 tipe habitatesh natyror sipas Listës së Habitave të NATURA 2000, prej të cilave 3 tipe habitatesh janë prioritare. Në RNM Patok-Fushëkuqe-Ishëm janë evidentuar 16 tipe habitatesh natyror prej të cilave 3 tipe habitatesh janë listuar si prioritare,



Rezervati Natyror i Menaxhuar
Kune – Vain – Tale – Patok –
Fushëkuqe – Ishëm

AdZM Lezhë

Përbërja e mjedisit ligatinor:

Laguna e Kunes
Laguna e Merxhanit
Laguna e Knallës e Cekës
Laguna e Vainit
Delta e lumit Drin
Laguna e Patokut
Delta e lumit Mat
Kënetë e Godullës

Shpendët që hasim në park:

Gargulli
Shqipja e kënetës
Cafka e vogël e bardhë
Bajza
Karabullaku i vogël
Pulëbardha këmbëverdhe juvenile

Specie të spikatura të florës:

Pisha e detit
Rrenja
Dëllinja e zezë
Plepi i egër
Murrizi njëbërthamësh
Pisha e egër
Pisha e butë



P.K Divjakë-Karavasta është një zonë e mbrojtur, e cila përbëhet nga ekosisteme komplekse shumë të pasura në biodiversitet e burime natyrore. Ky park mban titullin Ramsar si një zonë me rëndësi të veçantë për shpendët e ujit.

Laguna e Karavastasë shtrihet midis dy grykëderdhjeve, atë të lumit Seman dhe Shkumbin. Bregu perëndimor i lagunës ka disa ishuj të vegjël, të krijuar më tepër nga akumulimet organike të shpendëve, ku ata folezojnë. Dallohet Ishulli i Pelikanëve (MN). Laguna e Karavastasë rrethohet me ligatina, më tepër në formën e moçaleve, në të cilat zhvillohet bimësia kryesisht barishtore halofite e llojit *Salicornia europaea* L herbacea.

Në PK të Divjakë-Karavastasë janë evidentuar rreth 16 tipe habitatesh, sipas Listës së Habiteteve të NATURA 2000, prej të cilave 6 tipe habitatesh janë listuar si prioritare.



AdZM Fier

Përbërja e mjedisit ligatinor:

Laguna e Karavastasë

Këneta e Osmanit

Godulla e kularit

Laguna e Bedatit dhe e Ushtarit

Grykëderdhja e lumit Seman

Grykëderdhja e lumit Shkumbin

Shpendët që hasim në park:

Pelikani kaçurrel

Karabullaku i pigmentuar

Rosa kokëbardhë

Dallëndyshja e vogël e detit

Çafka e madhe e bardhë

Çafka e murrme

Gushëkuqi

Gjeraqina e zezë

Lauresha me kreshtë

Specie të spikatura të florës:

Asteri (*Aster albanicus*)

Salepët (*Orchis albanica*)

Fieri i Krojeve (*Adiantum*

capillus-veneris)

Fieri mashkull (*Dryopteris filix-mas*)



P.M Pishë Poro - Nartë dominohet nga peizazhi i pishës i gërshetuar me dunat e rërës dhe thyerjet në territor që shkakton lumi Vjosa. Laguna e Nartës bën pjesë në lagunat e mëdha të bregdetit tonë në Adriatik. Laguna e Nartës së bashku me deltën e Lumit Vjosa, Lagunën e Kallëngas dhe Kepin e Dajlanit, janë formuar nga prurjet aluvionale të lumit të Vjosës. Në brendësi të kësaj lagune gjendet Ishulli i Zvernecit, i mbuluar nga pylli i selvisë, me në qendër Monumentin e Kulturës “Manastiri i Shën Mërisë”. Pishë Poro përbëhet nga pyje të pishës së detit, të instaluara 50 vite më parë, dhe një vijë bregdetare ranore e gjerë.

Në P.M Pishë Poro - Nartë janë evidencuar 18 tipe habitatesh, sipas Listës së Habitatesh të Natura 2000, prej të cilave 6 tipe të listuara si prioritare. Kjo zonë e mbrojtur, pjesë e rrjetit Emerald për shkak të shumëllojshmërisë së shpendëve, njihet ndryshe edhe si shtëpia e flamingove.

Peizazhi i Mbrojtur Pishë Poro - Nartë



AdZM Vlorë

Përbërja e mjedisit ligatinor:

Laguna e Nartës
Laguna Limopuo
Laguna e Këllengas
Kepi i Dajlanit
Grykëderdhja e lumit Vjosa
Dunat e rërës
Ishulli i Zvërnecit

Shpendët që hasim në park:

Flamingo
Pelikani kaçurrel
Qyrylyku i vogël
Bishtëbardha e gurit
Vrapuesi i vogël
Dallëndyshja e detit
Skifteri kthetrazi

Specie të spikatura të florës:

Plepi i bardhë
Orkidea (orchis albanica)
Xina (Pistacia lentiscus)
Shelgje
Pylli i Pishës
Pylli i Selvisë



AdZM Vlorë

Parku Kombëtar i Butrintit përbëhet nga një shumëllojshmëri habitatesh natyrore, nga ato detare dhe ligatinore në perëndim në habitatet malore në lindje. Ndërthurja e tyre me site arkeologjike e kulturore krijon një peizazh të veçantë në Mesdhe. Laguna është shpallur si zonë Ramsar në vitin 2003 për rëndësinë që ajo mbart për shpendët shtegtarë. Habitatet detare, janë mjedise të përshtatshme për Breshkat e detit (*Caretta caretta*) dhe për gjitarët detarë, ku deri më tani njihen Delfini *Tursiops truncatus* e *Delphinus Delphi*.

Në habitatet e P.K të Butrintit jetojnë rreth 35 lloje gjallesash globalisht të kërcënuara. Në habitatet e tij jetojnë: rreth 247 lloje shpendësh, prej të cilëve 70% janë shpendë ujorë; 9 lloje amfibësh, 25 lloje reptilësh dhe 39 lloje gjitarësh.



AdZM Vlorë

Përbërja e mjedisit ligatinor:

Liqeni i Butrintit
Liqeni i Rrëzës (Bufit)
Pylli i Butrintit
Kanali i Vivarit
Burimet e kripura të Mullerit
Ishujt e kepit të Stilos

Shpendët që hasim në park:

Bilbili i kallamishteve
Gakthi i vogël
Kryekuqja mjeme
Kojliku sqepbollë
Shpendët e baltinave

Specie të spikatura të florës:

Fenerogami
Bivalori
Kaulmaku bregdetar
Metlika dalmate
Sherebela
Ilaja
Rrënja
Vërriu
Vidhi
Frashëri



